

**Lënda:** KSC-BC-2020-07  
**Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Për:** Gjykatësin e Procedurës Paraprake

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Parashtruesi:** Mbrojtësi i Specializuar i Nasim Haradinajt

**Data:** 18 qershor 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Kërkesë e Mbrojtjes për Ndryshimin e Kalendarit Përmbledhës**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtja e Nasim Haradinajt**

Tobi Kadman

Karl Bakli

**Mbrojtjes së Hysni Gucatit**

Xhonatan Elistan Ris QC

Hju Bauden

## I. KLASIFIKIMI

1. Këto parashtime klasifikohen si 'publike' pasi duket se nuk përmbajnë asgjë që do të kërkonte të shënohen si konfidenciale.

## II. HYRJE

2. Më 8 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori urdhrin që përmbante kalendarin përmbledhës.<sup>1</sup>
3. Në përputhje me atë kalendar, Mbrojtja duhej të parashtonte, nëse dëshironte, dosjen e vet paraprake deri më 14 qershor 2021.
4. Gjithashtu, në përputhje me atë kalendar, Mbrojtja duhej të parashtonte kundërshtimet e saj në lidhje me pranueshmërinë e provave në pajtim me rregullën 102, deri të hënën, datë 14 qershor 2021.
5. Më 9 qershor 2021, në paragrafin 19 të *Kalendarit të Rishikuar për Pjesën e Mbetur të Procedurës Paraprake dhe Urdhrit për Caktimin e Datës për Mbajtjen e Konferencës së Gjashtë mbi Ecurinë e Çështjes*,<sup>2</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake theksoi se ishin lëshuar "disa vendime mbi nxjerrjen e materialeve" dhe se "janë bërë disa nxjerrje materiale, ku përfshihet edhe një sasi voluminoze meta të dhënash".

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-07/F00148

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-07/F00224

6. Rrjedhimisht, dhe duke qenë se ende nuk ishin marrë vendime në lidhje me kërkesa të tjera, Gjykatësi i Procedurës Paraprake zgjati afatin për parashtrimin e dosjeve paraprake të Mbrojtjes.
7. Po kështu u zgjat edhe afati i Mbrojtjes për parashtrimin e 'kundërshtimeve mbi pranueshmërinë e provave'.
8. Për rrjedhojë, në përputhje me paragrafin 22 të atij urdhri, afatet përkatëse u zgjatën me 8 ditë, përkatësisht deri më 22 qershor.
9. Mbrojtja parashtron se është e pamundur t'u përmbahet afateve të përcaktuara në kalendarin dhe urdhrin e lartpërmendur dhe kërkon zgjatjen e tyre me arsyetimin e dhënë në parashtrimet me shkrim të dorëzuara para konferencës së pestë mbi ecurinë e çështjes, si edhe në parashtrimet më të gjera të bëra në të njëjtën konferencë mbi ecurinë e çështjes.

### III. HISTORIKU

10. Në kuadër të këtyre parashtrimeve, historiku i mëposhtëm konsiderohet i rëndësishëm, ku përfshihen datat e nxjerrjeve të materialeve prej ZPS-së.
11. Më 04/01/2021, 06/01/2021, 19/02/2021, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 2.
12. Më 06/01/2021, 19/02/2021, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 3.

13. Më 19/02/2021, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 4.
14. Më 28/01/2021, 19/02/2021, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 5.
15. Më 19/02/2021, 09/04/2021, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 6.
16. Më 18/02/2021, 19/02/2021, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 7.
17. Më 04/03/2021, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 8.
18. Më 09/03/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 9.
19. Më 09/04/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 10.
20. Më 12/03/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 11.
21. Më 15/03/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 12.
22. Më 17/03/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 13.
23. Më 18/03/2021, 19/03/2021, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 14.
24. Më 19/03/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 15.
25. Më 25/03/2021, 26/03/2021, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 16.
26. Më 25/03/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 17.
27. Më 25/03/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 18.
28. Më 09/04/2021, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 19.

29. Më 09/04/2021, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 20.
30. Më 09/04/2021, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 21.
31. Më 14/04/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 22.
32. Më 22/04/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 23.
33. Më 27/04/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 24.
34. Më 28/04/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 25.
35. Më 28/04/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 26.
36. Nuk duket se ka një nxjerrje numër 27.
37. Më 07/05/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 28.
38. Më 14/05/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 29.
39. Më 25/05/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 30.
40. Më 26/05/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 31.
41. Nuk duket se ka një nxjerrje numër 32.
42. Më 02/06/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 33.
43. Më 07/06/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 34.
44. Më 11/06/21, ZPS-ja qarkulloi nxjerrjen numër 35.

#### IV. PARASHTRIMET

45. Sipas urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, dosja paraprake e Mbrojtjes si edhe parashtrimet që kundërshtojnë pranueshmërinë e provave, nëse do të ketë të tilla, tani duhet të dorëzohen deri më 22 qershor 2021.
46. Për arsyet e dhëna në parashtrimet me shkrim para konferencës së pestë mbi ecurinë e çështjes dhe të shtjelluara më tej në të njëjtën konferencë mbi ecurinë e çështjes, dorëzimi brenda afatit të ndryshuar mbetet i pamundur dhe për rrjedhojë kërkohet zgjatje e atij afati.
47. Më 24 shkurt 2021, në konferencën e dytë mbi ecurinë e çështjes, ZPS-ja bëri të ditur se i kishte përmbushur detyrimet e saj sipas rregullës 102(1)(b) për nxjerrjen e materialeve, e cila në atë fazë përmbante 3.000 faqe prova si edhe prova në formë videomaterialesh me një kohëzgjatje të konsiderueshme.
48. Në atë fazë, ZPS-ja kishte bërë shtatë nxjerrje materialesh më vete.
49. Pohimi i ZPS-së në atë kohë ishte tejet i pasaktë.
50. Në konferencën e tretë mbi ecurinë e çështjes, ZPS-ja iu referua dy kërkesave ende të pazgjidhura drejtuar palëve të treta, duke mos dhënë informacion lidhur me sasinë e materialeve të tjera që mund të jenë objekt i nxjerrjes, megjithëse parashtroi se "*pjesa më e madhe*" e materialit ishte nxjerrë.

51. Duke pasur parasysh çfarë ka ndodhur pas kësaj konference të tretë mbi ecurinë e çështjes, fraza 'pjesa më e madhe', është qartazi e pakuptimtë.
52. Sidoqoftë, në atë fazë, nuk kishte asnjë tregues se kërkesat e pazgjidhura të ZPS-së do të kishin ndikim mbi afatet e propozuara për parashtrimet e Mbrojtjes.
53. Më 23 prill 2021, u bënë nxjerrje të tjera materialesh nga ZPS-ja, vetëm 1 ditë para konferencës së planifikuar mbi ecurinë e çështjes.
54. Nxjerrja e materialeve e bërë më 23 prill ishte nxjerra numër 23.
55. Siç u theksua edhe në parashtrimet me gojë në konferencën e pestë mbi ecurinë e çështjes, ajo nxjerrje përfshinte **17 dosje** me dokumente, përkatësisht rreth **8.500** faqe material.
56. Për këtë arsye, komentet e bëra nga ZPS-ja më 24 shkurt ishin, siç theksohet më sipër, tejet të pasakta.
57. Ky qëndrim i ZPS-së u bë edhe më i pasaktë me nxjerrjen e materialeve të tjera nga ZPS-ja pikërisht para konferencës së pestë mbi ecurinë e çështjes, kur u nxorën edhe 18.549 faqe të tjera me dokumente.
58. Brenda një periudhe prej afërsisht 6 javëve, ZPS-ja ka nxjerrë mbi 27.000 faqe dokumente, me gjithë pohimin e saj në shkurt se kishte përmbushur

detyrimin e nxjerrjes së materialeve me vetëm 3.000 faqe materiale të nxjerra.

Kjo shifër është rritur **nëntëfish**.

59. ZPS-ja tani ka bërë 33 nxjerrje më vete të sasive të ndryshme materialesh.
60. Megjithëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake u referohet dokumenteve të shumta si 'meta të dhëna', pavarësisht nga përmbajtja e këtyre dokumenteve, ato duhet të shqyrtohen dhe, sipas nevojës, të merren udhëzime në lidhje me to.
61. Mbrojtja pranon se me ecurinë e çështjes mund të ketë nxjerrje materialesh të tjera jodomosdoshmërisht të parashikueshme, megjithatë, pozicioni në të cilin e gjen veten Mbrojtja aktualisht është, me gjithë respektin, i pakuptimtë.
62. Në kohën kur sugjeroi se i kishte përmbushur detyrimet e saj, ZPS-ja kishte bërë vetëm 7 nxjerrje materialesh, ndërsa deri më sot janë bërë 33 nxjerrje më vete.
63. Thjesht nuk është me vend që Mbrojtjes t'i kërkohet t'u përmbahet afateve të përcaktuara në rrethana kur janë dhënë garanci se detyrimet për nxjerrje janë përmbushur me 3.000 faqe material, ndërkohë që realiteti qartë tregon se këto detyrime në asnjë mënyrë nuk janë përmbushur dhe për më tepër, numri i nxjerrjeve të materialeve është rritur nëntëfish në krahasim me numrin e nxjerrjeve të materialeve të bëra fillimisht.



64. Megjithëse është miratuar zgjatje e afatit me 8 ditë, më gjithë respektin, kjo është gjithsesi e pamjaftueshme.
65. Sërish, me përsëritjen e parashtrimeve të bëra më parë si dhe parashtrimet dhe pohimet e saj se jo çdo faqe e nxjerrë është më rëndësi, ZPS-ja po ngatërron mendimin me faktet.
66. Nuk i takon ZPS-së të përcaktojë se çfarë është e rëndësishme.
67. Nuk i takon ZPS-së që t'i diktojë Mbrojtjes se çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet të shqyrtojë.
68. Mbrojtja është e detyruar të lexojë çdo fjalë të secilës prej faqeve të materialeve të nxjerra; nuk mund të ketë kompromis në këtë pikë, pasi nëse Mbrojtja nuk e bën këtë gjë, kjo do të thotë të dëmtojë të pandehurin dhe përbën mospërbushje të detyrimeve profesionale të Mbrojtjes.
69. Për më tepër, duhet të theksohet se nuk është Mbrojtja ajo e cila i ka zgjatur gjërat, sepse ka qenë gjithmonë qëllimi i saj që të parashtronte dosjen e vet paraprake në përputhje me afatet e përcaktuara më parë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, megjithëse tani është e qartë se është e pamundur t'u përmbahet atyre afateve për shkak të praktikës së ZPS-së të nxjerrjes një nga një të materialeve.

70. Rrjedhimisht, Mbrojtja rikonfirmon afatet e reja të propozuara në parashtrimet gojore gjatë konferencës së pestë mbi ecurinë e çështjes, përkatësisht zgjatjen e afatit për dorëzimin e dosjes paraprake me 28 ditë, të paktën deri më 12 korrik 2021.
71. Gjithashtu, për shkak të problemeve me nxjerrjen e materialeve, propozohet që afati kohor për dorëzimin e parashtrimeve që konsiderohen të nevojshme në lidhje me pranueshmërinë e provave, të zgjatet njësoj me një periudhë prej 28 ditësh, deri më 12 korrik 2021.
72. Mbrojtja është e ndërgjegjshme për detyrimin e saj për të siguruar ecurinë e shpejtë të procesit, megjithatë, siç theksohet më sipër, vonesa është vetëm pasojë e qëndrimit dhe qasjes shpërfillëse të ZPS-së për sa i takon detyrimin të nxjerrjes së materialeve.
73. Për më tepër dhe sido që të jetë, një çështje është aktualisht nën shqyrtimin e panelit të Gjykatës së Apelit dhe pritet vendim në lidhje me të.
74. Gjithashtu, rishtas u miratua leje për apel edhe në lidhje me një pikë të dytë.<sup>3</sup>
75. Për rrjedhojë, zgjatja e afatit për parashtrimin e dosjes paraprake dhe kundërshtimeve në lidhje me pranimin e provave nuk do të shkaktojë vonesa

---

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-07/F00235

të mëtejshme, duke mbajtur parasysh pikat e përmendura më sipër, të cilat duhet të zgjidhen nga paneli i Gjykatës së Apelit.

76. Duke marrë parasysh afatet për dorëzimin e parashtrimeve në lidhje me pikën për të cilën u miratua leje për apel kohët e fundit, thuajse nuk ka shumë të ngjarë që të merret ndonjë vendim apeli para afatit të ri të propozuar për parashtrimin e dosjes paraprake.

## V. PËRFUNDIM

77. Në kohën e përcaktimit të kalendarit për paraqitjen e parashtrimeve, afatet e vendosura ishin realiste dhe të përshtatshme, duke u mbështetur në qëndrimin e shprehur nga ZPS-ja në lidhje me detyrimet e saj për nxjerrjen e materialeve dhe faktin nëse ZPS-ja i kishte përmbushur ato detyrime, ose do t'i përmbushte brenda një kohe të shkurtër.
78. Megjithatë, ecuria e deritanishme e kësaj çështjeje gjyqësore ka demonstruar se qëndrimi i marrë nga ZPS-ja ishte krejtësisht i pasaktë dhe, për rrjedhojë, kalendari i përcaktuar më parë është po ashtu i pasaktë në kuptim të mundësisë reale për t'iu përmbajtur atyre afateve.
79. Në përputhje me sa më lart, Mbrojtja kërkon zgjatjen e të dy afateve të përmendura në këtë parashtrim, me kushtet e përshkruara, në mënyrë që të

sigurohet shqyrtimi i duhur i provave të nxjerra, përgatitja e çështjes dhe, ajo çfarë është më e rëndësishmja, moscenimi i të pandehurit.

80. Së fundi, parashtrohet se përmes miratimit të një zgjatjeje të mëtejshme të afateve, çështja nuk shtyhet në mënyrë të papërligjur, si duke marrë parasysh parimet e drejtësisë ashtu edhe apelet e pazgjidhura, që pamundësojnë kalimin e çështjes Trupit Gjykses.

Numri i fjalëve (në anglishte): 1853 fjalë

/nënshkrimi/

**Tobi Kadman**

**Mbrojtës i Specializuar**

/nënshkrimi/

**Karl Bakli**

**Bashkëmbrojtës i Specializuar**